

## Vrasja në Balaj të Ferizaj, i dyshuari ndalohet për 48 orë

LAJME



16/09/2025 10:05

f

t

l

Një vrasje ka ndodhur mbrëmë rreth orës 19:42 në fshatin Balaj të Ferizajt ku një 40-vjeçar mbeti i vdekur.

Për këtë rast, Prokuroria Themelore në Ferizaj ka njoftuar sot se i dyshuari me initiale B.R., është ndaluar në kohëzgjatje prej 48-orësh, për shkak të dyshimit të veprës penale “Vrasja”.

“Prokurori kujdestar nga Departamenti për Krime të Rënda, ka dalë në vendin e ngjarjes, nga aty në bashkëpunim të plotë me Policinë e njësitë relevante kanë ndërmarrë veprime hetimore, me qëllim të ndriçimit të rrethanave të kësaj ngjarje. Me vendim të prokurorit të shtetit, i dyshuari me initiale B.R., është ndaluar në kohëzgjatje prej 48-orësh, për shkak të dyshimit të veprës penale “Vrasja” sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës”, thuhet në njoftimin e prokurorisë.

Ndërsa, trupi i pajetë i viktimës është dërguar në Institutin e Mjekësisë Ligjore (IML), në Prishtinë, për obduksion.

Po ashtu lidhur me rastin nga Prokuroria Themelore në Ferizaj, ka thënë se është duke u punuar për të sqaruar tutje të gjitha rrethanat dhe motivin e kësaj çështje penale.

“Prokurori i Shtetit, brenda afatit ligjor do të paraqesë kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit ndaj të dyshuarit, pranë gjykatës kompetente”, theksohet në njoftim.

Në këtë rast theksohet se janë shkrepur rreth 4 plumba.

“Vdekjen e viktimës e ka konstatuar ekipi mjekësor, ndërsa njësitet policore në vendin e ngjarjes kanë gjetur dhe konfiskuar pistoletën dhe 4-gëzhoja që dyshohet se janë shkrepur nga i dyshuari”, thuhet në njoftim.

Lidhur me këtë rast, Policia njoftoi se gjatë kontrollit në shtëpinë e të dyshuarit është gjetur edhe një pushkë gjuetie, me 72 fishekë cal-12mm dhe një pushkë ajrore.

“Me urdhër të prokurorit trupi i pajetë i viktimës është dërguar në IML për obduksion, ndërsa i dyshuari është dërguar në mbajtje. Rasti duke u hetuar”.

I dyshuari për vrasjen është një burrë rreth të 50-tave, gjithashtu me inicialet Bekim Rramusa- sipas informacioneve të para viktima dhe i dyshuari në këtë rast janë familjar, më saktësisht djem të axhës.


Viktima la pas vetes gruan dhe katër fëmijë. **/Lajmi.net/**

### LAJME TË FUNDIT

- 

E turpshme: Shpejtim Bulliqi, i kërkon Ekrem Hysenit...
- 

Dëshmia e Rubin, Deda: ShBA-të nuk lejojnë që angazhimi i tyre të njolloset
- 

Ish-ndihmës sekretari amerikan i shtetit, James Rubin vazhdon...
- 

A u arrestua apo jo Mozzik? – Avokati Koci tregon të vërtetën

### Artikuj të ngjashëm



September 16, 2025  
**E turpshme: Shpejtim Bulliqi, i kërkon Ekrem Hysenit t’ia dëshmoj me...**

### Other Links

- Fact-Checking Policy

Ethics Policy

Corrections Policy

Ownership & Funding Information

Editorial Team Information